

V E N D I M
Nr.166, datë 7.4.1999

**PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË FORCAVE USHTARAKE TË NATO-S SË HAPËSIRËS
AEROPORTUALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr.8470, datë 7.4.1999 “ Për pranimin në Shqipëri të një force të NATO-s, në mbështetje të operacioneve ushtarake në rajon”, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Vënien në dispozicion të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) të hapësirës ajore e detare, si dhe aeroportet e portet detare të Republikës së Shqipërisë, për t’u përdorur nga avionët, helikopterët, anijet dhe pajisjet e tjera ushtarake të kësaj organizate.

2. Krijimin e lehtësive të nevojshme për përdorimin dhe kontrollin e hapësirës ajrore e detare të Republikës së Shqipërisë nga forcat ushtarake të NATO-s.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Rendit Publik për realizimin, koordinimin dhe bashkëpunimin me forcat ushtarake të NATO-s, në zbatim të këtij vendimi.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.616, datë 10.10.1998, dhe nr 827, datë 30.12.1998 “ Për krijimin e lehtësirave të veprimtarisë së avionëve dhe të anijeve ushtarake të Organizatës të Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) në Republikën e Shqipërisë” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko